




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Kompanitë në listë të zezë ofertojnë dhe fitojnë tender



Kompanitë në listë të zezë ofertojnë dhe fitojnë tender

Autor: Agon Hysaj

Gusht 2021

Ky raport është përgatitur nga Demokracia Plus (D+) dhe mbështetur nga USAID përmes aktivitetit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Qëndrimet e autorit të shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Sipas nenit 99.2 të Ligjit për Prokurimin Publik, kompanitë mund të diskualifikohen (apo vendosen në Listën e Zezë) nga pjesëmarrja në prokurimin publik deri në 12 muaj. Arsyet pse një kompani diskualifikohet janë deklarata e rreme ose/dhe falsifikimi i dokumenteve. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) merr vendim për diskualifikim pas kërkesës së bërë nga ndonjë autoritet kontraktues. OSHP publikon në uebfaqen e saj të gjitha vendimet për diskualifikim, përfshirë rastet ku kërkesa e autoritetit kontraktues është refuzuar.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) përveç që nuk ka ndërmarr asnjë masë që të ju pamundësojë përmes platformës së e-Prokurimit këtyre operatorëve ekonomik të marrin pjesë në aktivitetet e prokurimit, në muajin tetor të vitit 2020 ka nxjerrë një interpretim diskutabil për këtë çështje. Sipas KRPP-së edhe nëse një operator ekonomik është nxënë duke falsifikuar dhe/apo mashtruar në prokurim publik, ai duhet lejuar të marrë kontrata të reja nëse aktiviteti i prokurimit ka filluar para datës së përfshirjes së operatorit në listë të zezë. KRPP me këtë interpretim ka shkelur Rregulloren e Punës së OSHP-së e cila thotë qartë se: “[n]ëse diskualifikimi aprovohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, atëherë operatori ekonomik i diskualifikuar nuk mund të merr pjesë në asnjë aktivitet të prokurimit që përfshinë aktivitetet e prokurimit aktuale dhe të ardhshme. Diskualifikimi është i vlefshëm nga momenti i nxjerrjes së vendimit lidhur me diskualifikimin, deri në periudhën kohore të përcaktuar në vendim të panelit shqyrtues. Për qëllime të kësaj dispozite aktiviteti i prokurimit ndër të tjerash përfshinë edhe nënshkrimin e kontratës publike me autoritetin kontraktues”.¹

Ky opinion, ka mundësuar që shumë kontrata të lidhen me kompani që janë diskualifikuar, pasi autoritetet kontraktuese kanë vepruar sipas këtij opinioni. KRPP përveç që nuk ka bërë asgjë që 3 vite (prej se D+ ka vërtetuar që kompani që janë të diskualifikuara fitojnë kontrata) për të parandaluar këto kompani që të ofertojnë, tani me opinionin e saj i ka dhënë më shumë hapësirë kompanive të diskualifikuara që të fitojnë kontrata. Autoritetet kontraktuese nuk do të kenë siguri gjatë zbatimit të kontratës pasi ato po detyrohen të lidhin kontrata me kompani të diskualifikuara.

Demokrasi Plus duke shfrytëzuar të dhënat e hapura nga platforma [e-Prokurimi](#) ka gjetur se nga 1 janar 2019, shtatë (7) kompani kanë ofertuar në 22 tenderë gjatë kohës sa kanë qenë të diskualifikuara. Në 13 prej 22 tenderëve, autoritetet kontraktuese kanë lidhur kontratë me këto kompani. Në dy tenderë tjerë, autoriteti kontraktues ka eliminuar kompaninë që ka ofertuar pikërisht për arsye se është diskualifikuar nga OSHP.

Pjesa në vazhdim e këtij raporti tregon rastet e kontratave të lidhura me kompani të diskualifikuara, apo kompani në Listë të Zezë.

- 1) Komuna e Vushtrrisë ka nënshkruar kontrate në vlerë 25,000 euro me kompaninë Interlab SH.P.K më 11 mars 2021. Interlab është diskualifikuar nga data 1 shkurt 2021 deri më 31 janar 2022. Kjo kontratë është lidhur pas opinionit të KRPP-së dhe sic duket komuna ka vepruar sipas këtij opinioni. Megjithatë edhe po të eliminohej kompania Interlab me arsyen së ëshë diskualifikuar, komuna nuk do të gabonte.
- 2) Ministria e Infrastrukturës ka lidhur aneks kontratë në vlerë 149,785.99 euro me kompaninë R & Rukolli SH.P.K. më 5 maj 2021, ndërsa kompania është diskualifikuar nga data 9 dhjetor 2020 e deri më 8 qershor 2021.
- 3) Komuna e Pejës ka lidhur kontratë në vlerë 256,872.50 euro me kompaninë Arfa Group SH.P.K. më 17 dhjetor 2019 e cila ka qenë në listë të zezë nga data 19 nëntor 2019 e deri më 18 maj 2020.

¹ Rregullore 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit. Neni 32.2 – Qasur më 15.07.2021 <https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Download?id=0d49ce49-afc2-eb11-b59b-005056ba09d5>

- 4) Një tjetër kontratë e lidhur me Arfa Group SH.P.K. si pjesë e një konsorciumi është nënshkruar nga Komuna e Rahovecit me vlerë mbi 1.7 milion euro. Kontrata është lidhur më 20 dhjetor 2019, rreth një muaj pasi Arfa Group është diskualifikuar. Sipas nenit 71 të Ligjit për Prokurim Publik nëse njëri nga anëtarët e konsorciumit është i papërgjegjshëm, atëherë i gjithë konsorciumi cilësohet si i papërgjegjshëm.
- 5) Kompania N.T.P. Vlora ka fituar nëntë kontrata me një vlerë totale prej 137,384.06 euro pasi është diskualifikuar. N.T.P. Vlora është futur në Listë të Zezë më 3 shtator 2020 deri më 2 mars 2021. Edhe pse për të gjitha nëntë kontratat, ofertat janë dorëzuar para se N.T.P. Vlora të diskualifikohet, sipas Rregullores së Punës së OShP-së², operatori ekonomik nuk mund të nënshkruajë kontratë nëse është i diskualifikuar.

Në tabelën më poshtë janë të gjitha ofertat dhe kontratat që janë fituar gjatë kohës sa kompanitë kanë qenë të diskualifikuara.

Operatori Ekonomik	Data e diskual.	Data e përfundimit	Autoriteti Kontraktues	Data e ofertës	Data e kontratës
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	Komuna e Vushtrrisë	27-04-21	
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	Komuna e Shtimes	12-05-21	
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	Dogana e Kosoves	15-04-21	
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	Ministria e Punëve të Jashtme	21-04-21	
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	Dogana e Kosovës	12-04-21	
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	Komuna e Gracanicës	26-05-21	
AS Tech SH.P.K	15-02-21	14-08-21	KRM Pastërtia	11-05-21	
Basri Sopjani B.I	15-02-21	14-08-21	Qendra Multifunkionale Sh.A	16-02-21	
Interlab SH.P.K.	01-02-21	31-01-22	Komuna e Vushtrrisë	14-12-20	11-03-21
R & Rukolli	09-12-20	08-06-21	Ministria e Infrastrukturës	20-04-21	05-05-21
Sallahu SH.P.K	03-07-19	03-01-20	Iber Lepenci Sh.A	26-12-19	
Arfa Group SH.P.K.	19-11-19	18-05-20	Komuna e Pejës	12-11-19	17-12-19
Arfa Group SH.P.K.	19-11-19	18-05-20	Komuna e Rahovecit	21-08-19	20-12-19
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Dogana e Kosoves	20-08-20	19-10-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Komuna e Skënderajt	13-07-20	29-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Komuna e Suharekës	17-07-20	23-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	02-09-20	23-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Qendra e Shëndetit Mendor Prizren	26-08-20	21-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	20-08-20	14-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Universiteti Haxhi Zeka	06-08-20	08-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	KRM Pastrimi	22-07-20	07-09-20
N.T.P. Vlora	03-09-20	02-03-21	Spital i Përgjithshëm - Pejë	30-07-20	07-09-20

Tabela 1 – Kompanitë të cilat kanë ofertuar dhe/ose fituar tender gjatë kohës sa kanë qenë të diskualifikuara

² Organi Shqyrtues i Prokurimit. Rregullorja e Punës. Neni 32. 2020.

<https://oshp.rks-gov.net/sq/Documents/Doenload?Id=3e587b88-145e-ea11-b58b-005056ba09d5>

Dogana e Kosovës si autoritet kontraktues e ka eliminuar kompaninë As Tech SH.P.K. në dy tenderë të saj me arsyen që është e diskualifikuar nga OSHP. Mirëpo, të njëjtën gjë nuk e ka bërë për kompaninë N.T.P. Vlora, me të cilën ka nënshkruar kontratë edhe pse kompania ka qenë në atë kohë e diskualifikuar.

Mirëpo pse ndodh që kompanitë e diskualifikuara të ofertojnë dhe të fitojnë kontrata. Arsyeja është pasi pjesa më e madhe e autoriteteve kontraktuese gjatë vlerësimit të ofertave nuk marrin parasysh Listën e Zezë, të publikuar në uebfaqen e OSHP-së. Arsye tjetër është se nuk ka mekanizëm që ua ndalon këtyre kompanive të ofertojnë. Kjo mund të bëhet në e-Prokurim duke bllokuar mundësinë që ato të dorëzojnë oferta gjatë periudhës së diskualifikimit. Ligji i Prokurimit Publik nuk parasheh ndëshkim tjetër për kompanitë e përmendura më lartë pasi kanë shkelur vendimin e OSHP-së për diskualifikimin e tyre.

Mungesa e mekanizmave ndëshkues për kompanitë që dorëzojnë ofertë dhe fitojnë kontrata gjatë kohës së diskualifikimit të tyre ndikon në kredibilitetin e sistemit të prokurimit në Kosovë. Kjo mund të nxisë kompanitë tjera që të tentojnë të fitojnë tender kur e shohin që nuk ka pasoja në ofertojnë gjatë periudhës së diskualifikimit. Nga viti 2019 e deri më sot janë diskualifikuar 20 kompani, ndërsa shtatë prej tyre (apo 35%) kanë dorëzuar ofertë gjatë kohës sa kanë qenë në Listë të Zezë.

Mungesa e mekanizmave ndëshkues ka lejuar që kompanitë që janë në Listë të Zezë të mund të ankohen në OSHP. Kompania Interlab Sh.P.K. më 26 prill 2021 është ankuar në OSHP kundër vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për dhëni të kontratës. Tenderi ka të bëjë për furnizim me material laboratorik për testim për SARS-COV-2. Pasi bordit të OSHP-së i ka skaduar mandati më 31 mars 2021, ankesat e kompanive nuk mund të shqyrtohen. Kjo nënkupton që një tender shumë i rëndësishëm është bllokuar nga një ankesë e një kompanie që është në Listë të Zezë, e cila nuk ka gjasa që të fitojë kontratën.

Duke marrë parasysh këtë dukuri në rritje, Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) si administrues i platformës së e-Prokurimit duhte që t'ua pamundësojë kompanive të diskualifikuara që të marrin pjesë në aktivitete të prokurimit. Kjo mund të bëhet duke ua pamundësuar qasjen në llogari të e-Prokurimit kompanive që janë në Listë të Zezë. Qasja në llogari do të lejohej në mënyrë automatike në momentin që përfundon diskualifikimi. Ky veprim siguron që kompanitë që janë të diskualifikuara nuk mund të fitojnë kontrata. Në anën tjetër autoritetet kontraktuese e kanë më të lehtë vlerësimin e ofertave. Në fund, besimi në prokurimin publik në Kosovës rritet, pasi kompanitë që mashtrojnë nuk mund të fitojnë kontrate publike.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

